



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**VENDIM**

**K.P.P. 429/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.07.2019, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Nelsa” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt *Loti III “Blerje ushqime kolonjare dhe zarzavate*”, me nr. REF-15825-03-28-2019, me fond limit për njësi 7278 lekë (pa TVSH) dhe vlerë të pritshme të kontrtaës 2,656,486 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 02.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Nelsa” sh.p.k.  
*Adresa: Qesarakë, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër  
*Adresa: Rr. “Bujar Bishanaku”, pranë stadiumit “Loro Boriçi” Shkodër.*

**Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “Sead SGS” sh.p.k.  
*Adresa: Lagjia Kashar 2, Rr. “Mullishtër”, godinë 1-katëshe, nr. pasurie 4, z.k 2105, Kashar, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### ***Vlerësimi paraprak***

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### ***Rrethanat e çështjes***

II.1 Në datën 29.03.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt *Loti III “Blerje ushqime kolonjare dhe zarzavate*”, me nr. *REF-15825-03-28-2019*, me fond limit për njësi 7278 lekë (pa TVSH) dhe vlerë të pritshme të kontraktës 2,656,486 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën *02.05.2019*, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër.

II.2 Në datën 02.05.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 08.05.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- |                       |                           |
|-----------------------|---------------------------|
| 1. ”Nika” sh.p.k.     | 2,805 lekë, Skualifikuar; |
| 2. “Erdis” sh.p.k.    | 2,905 lekë, Skualifikuar; |
| 3. “Nelsa” sh.p.k.    | 3,055 lekë, Skualifikuar; |
| 4. “Sead SGS” sh.p.k. | 3,570 lekë, Kualifikuar;  |

II.4.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Nelsa” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

*“1.Operatori ekonomik nuk ploteson pike 9 te kapacitetit teknik: Operatori ekonomik i cili do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentin provues, që vërteton se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.*

*2. Operatori ekonomik nuk ploteson pike 1 te kriterëve te pergjithshme te pranim/kualifikimit: Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe (certifikatat ISO nuk janë te perkthyerane gjuhen shqipe).”*

II.5.Në datën 14.05.2019, operatori ekonomik “Nelsa” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 631/1 Prot. datë 17.05.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Nelsa” sh.p.k, duke e pranuar pjesërisht ankesën e paraqitur prej tij, me argumentimin si më poshtë vijon:

*“[...] 1. Ne lidhje me pretendimin e pare, pika 3 e kapacitetit teknik: Operatori ekonomik duhet të plotësojë standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesë dokumentacion provues, ku të tregohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet, konform kërkesave ligjore. me pretendimin se kemi bere vedeklarim se nga kontrolli i fundit i AKU kemi rezultuar me te gjithë dokumentacionin tekniko -ligjore te rregullt, krahas saj kemi dorezuar edhe vertetim nga AKU. Komisioni i shqyrtimit te ankeses arsyeton si me poshte: ne dokumentat e paraqitur per kete pike citohet se: Operatori Ekonomik eshte subjekt qe kontrollohet nga AKU, por nuk ka nje raport kontrolli ose dokumentacion provues sipas DST qe kontrolli i fundit ndaj subjektit “NELSA“ SHPK eshte konform kerkesave ligjore. Per sa theksuam me siper komisioni nuk e merr per baze pretendimin e operatorit ekonomik.*

*2.Pretendimi i dyte i operatorit ekonomik qendron. [...]”*

II.7.Në datën 24.05.2019, operatori ekonomik “Nelsa” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*“[...]Kete arsye skualifikimi e kundërshtojmë si me poshte:*

*I.Ne dst te publikuara nga ana e AK nder te tjerat kerkohen ne piken 8 qe Operatori ekonomik i cili do të shpallet fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentin provues, që vërteton se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.*

*Se pari: Ne dst theksohet se përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentin provues, që vërteton se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore qe do te thote se ai subjekt qe do te shpallet fitues duhet ta dorezoje kete dokument provues perpara lidhjes se kontrates.*

*Se dyti : Ne zbatim te kesaj kerkese ne kemi dorezuar nje Vetdeklarim ku shprehemi se se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore dhe*

*Se treti: Ne zbatim te kesaj kerkese kemi dorezuar Vertetim te leshuar nga ana e AKU me nr prot 486/1 date 08.02.2018.*

*Se katerti : Ky kriter nuk eshte i qarte, pasi fakti nese eshte ushtruar kontroll i vazhdueshem ose jo nuk varet nga OE, por eshte kompetencë e AKU. Pra, ky kriter eshte ne tejkalim te pikes 1/b te nenit 46 te LPP-se, prandaj ky kriter nuk mund të shërbej si kriter skualifikues.*

*Per kete kritere ka terhequr vemendje dhe Agjensia e Prokurimit Publik ku shprehimish eshte shprehur se “Duke marrë shkas nga problematikat e konstatuara nga APP, në kuadër të monitorimeve të kryera prej saj, lidhur me hartimin e kritereve të pranimit, APP ju sjell në vëmendje të mbahen në konsideratë parashikimet e nenit 46 të LPP dhe nenit 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendorsja e çdo kriteri të vecantë, duhet të jetë e mirëargumentuar dhe e dokumentuar, konform parashikimeve ligjore. Në dokumentet e tenderave në sistemin elektronik ndër të tjera është konstatuar se: Në kapaciteti teknik, Autoritete Kontraktore kane kërkuar nga OE: “Vertetim leshuar nga AKU per vitin 2019 qe verteton se subjekti ofertues ka qene nen kontroll te vazhdueshem nga ky institucion”. Ky kriter nuk eshte i qarte, pasi fakti nese eshte ushtruar kontroll i vazhdueshem ose jo nuk varet nga OE, por eshte kompetencë e AKU. Pra, ky kriter eshte ne tejkalim te pikes 1/b te nenit 46 te LPP-se, prandaj ky kriter nuk mund të shërbej si kriter skualifikues. Në rastin, kur është e nevojshme ndryshimi i dokumenteve të tenderit përfshirë këtu edhe kriteret për kualifikim, mbështetur në përcaktimet e nenit 42 të LPP-së, Autoriteti Kontraktor nuk duhet të anullojë procedurën, por mund të bëjë ndryshime përmes hartimit të një shtojce, e cila ju vihet në dispozicion operatoreve ekonomikë, në DS T e publikuara në SPE. Argumenti i pare i skualifikimit nuk qendron.*

*II. Ne dst te publikuara nga ana e AK nder te tjerat kerkohen Operatori ekonomik ofertues qe do të realizojë këtë kontrate, duhet te jete i paisur dhe te paraqese çertifikatat perkatese të vlefshme si me poshte :*

*Çertifikate ISO 9001:2015 “Për Menaxhimin e Cilësisë“, objekti i se ciles te jete në përputhje me objektin e prokurimit.*

*Çertifikatën e Sistemit të menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018 ose ekuivalente, objekti i se ciles te jete në përputhje me objektin e prokurimit.*

*Keto certifikata jane te perkthyer ne gjuhen shqip, ate cka eshte shkruar ne gjuhen anglisht eshte e perkthyer ne certifikate ne gjuhen shqip. Ky pretendim eshte mare parasysh nga ana e AK ne ankesen qe ne ja kemi derguar ketij te fundit. [...]*

*II.8.Në datën 14.06.2019, me anë të shkresës nr.704/1prot., datë 07.06.2019, ka mbërritur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.*

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

*pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,*

## Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes "Nelsa" sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: "[...]1.Operatori ekonomik nuk ploteson pike 9 te kapacitetit teknik: Operatori ekonomik i cili do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentin provues, që vërteton se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore [...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën nr. 9, pika 2.2.8, "Kapaciteti teknik" në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

*"8-Operatori ekonomik i cili do të shpallet fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentin provues, që vërteton se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore"*

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*

III.1.3. Në nenin 27 "Kontrata e Mallrave" pika 6 gërma "c" të VKM 914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikohet se : *"[...] Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.[...]"*

III.1.4. Për të dhënë një gjykim sa më të drejtë dhe në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, Komisioni i Prokurimit Publik, shqyrtoi me vëmendje dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, nga ku konstatoi se, autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka vendosur si kriter të vecantë kualifikimi, detyrimin për të paraqitur në SPE dokument provues që vërteton se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, por e ka vendosur si kriter *ex-post*, pra, në mënyrë eksplicite, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se ky dokument duhet paraqitur nga operatori ekonomik pas shpalljes fitues dhe përpara lidhjes së kontratës. Në këto kushte, KPP gjykon se për të përmbushur kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit, operatorët ekonomik nuk kanë qenë të detyruar për të paraqitur paraprakisht në SPE dokumentin e kërkuar në shtojcën nr. 9, pika 2.2.8, "Kapaciteti teknik" në dokumentat standarte të tenderit, për sa kohë nga vetë autoriteti kontraktor është përcaktuar ndryshe. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor

për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në këto kushte, KPP gjykon se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga KVO është bërë në kundërshtim me nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet 2. *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*"

Sa më sipër, pretendimi e operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos:**

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik "Nelsa" sh.p.k, për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër", me objekt Loti III "Blerje ushqime kolonjare dhe zarzavate", me nr. REF-15825-03-28-2019, me fond limit për njësi 7278 lekë (pa TVSH) dhe vlerë të pritshme të kontratës 2,656,486 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 02.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "Nelsa" sh.p.k., si dhe të korrigojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Nelsa" sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 929 protokoli Datë 24.05.2019;**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**